



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:046391
Datë: 15.03.2024
Numri i dokumentit: 05455976

P. nr.240/2024

NE EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore-Departamenti i pergjithshem Penal në Prizren, me gjyqtarin gjykues Fatmir K., dhe sekretares juridike Fatime Bajraktari, në çeshtjen penale kundër të akuzuarit **S.K.**, nga Prizreni, me mbrojtësin e tij **av.M.Sh.**, nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndim i lehte trupor nga neni 185 par.3 lidhur me par.2 nenpar.3.2 e lidhur me par.1 nenpar.1.1 të KP-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore të shtetit në Prizren PP/II nr.199-1/2024 të dt.28.02.2024, pas mbajtjes së seancës të shqyrtimit fillestar gjyqësor, në prezencën e Prokurorit Themelor të shtetit në Prizren, Elfete Purrova, të akuzuarit dhe të dëmtuarave, me datë **06.03.2024** morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **S.K.**, nga i ati, e ëma, e vajzërisë, i lindur menë Prizren, ku edhe tani jeton, në rr.nr....., i martuar baba i 3 femijeve, shkollën e mesme të kryer, instruktor, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, nr.pers.,

ESHTE FAJTOR

Me datë 08.02.2024, rreth orës 19:00, në rr. "Haki Taha", nr.69 në Prizren, saktësisht në shtëpinë e përbashkët familjare me dashje dhe me qëllim i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarave R.M., dhe S.K., - viktimë të ndjeshme për shkak të marrëdhënieve që kanë, respektivisht ndaj bashkëshortes dhe vajzës së tij, në atë mënyrë që ditën kritike të pandehuri S.K., pasi që i kishte kërkuar telefonin të dëmtuarës S., dhe kishte kuptuar se ajo ka kontakt me një djalë për të cilin ishte në dijeni edhe bashkëshortja e tij, i nervozuar nga kjo situatë, fillimisht e sulmon të dëmtuarën S., duke e goditur me mjet të rrezikshëm i cili mjet mundë të shkaktoj lëndim të rëndë trupor, respektivisht me rripë, më pastaj e godet edhe me grushta, në atë moment e dëmtuara R. ndërhyjnë për ta mbrojtur vajzën, por i njëjti fillon ta sulmin tani fizikisht edhe të dëmtuarën R. duke e goditur me rripë, më pas i pandehuri të dëmtuarën S., e dërgon në një dhomë në katin e dytë të shtëpisë e mbyllë derën me qelës dhe ka vazhduar që ta sulmojë fizikisht S. në cilin bërthet nga dhimbjet e shkaktoara nga sulmi fizik, sërish e dëmtuara R. shkon largë në dhomë që ti dalë në mbrojtje S. ndërsa dera ka qenë e mbyllur me qelës, ku e dëmtuara e godet derën në mënyrë që i pandehuri ta hapë derën, poashtu i pandehuri e godet derën me grusht ku edhe e dëmton, vazhdoj ta sulmojë fizikisht të dëmtuarën R. duke e goditur

me grushta në pjesën e pasme të kokës, ku si pasojë e goditjeve të marra e dëmtuara R. M., pëson lëndime të lehta trupore, në formë të ndrydhjeve dhe gjak mbledhjes nën lëkurore në regjionin e nyjës së krahut dhe shpatullës së djathtë dhe regjionin ballor të kokës, të shkaktuara si rezultat i veprimit mekanik të mjetit të fortë, mbrretës (jo të mprehtë) me pasoja të përkohshme të shëndetit, ndërsa e dëmtuara S K., pëson lëndime të lehta trupore, në formë të ndrydhjeve dhe gjake mbledhjes nënlekurore në regjionin e shpinës dhe ekstremiteteve të poshtme të shkaktuara si rezultat i veprimit mekanik të mjetit të fortë, mbrretës (jo të mprehtë), me pasoja të përkohshme të shëndetit, lëndime këto të konstatuara në ekspertizën e mjekut ligjor Dr. N.U., të datës 17.02.2024.

Me këto veprime ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.3 lidhur me par. 2 nën par.3.2 e lidhur me par. 1 nënpar. 1.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr.06/L-074.

Gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70, 71, 72, dhe neni 185 par.3 lidhur me par. 2 nënpar.3.2 lidhur me par.1 e nënpar.1.1 të KP-së, si dhe neni 364 të KPPK-ës, te akuzuarin e :

GJYKON

DËNIM ME BURGIM

Në kohëzgjatje **prej 6 /gjashte/ muajve**, ne te cilin denim me burgim do te llogaritet edhe koha e kaluar ne masen e paraburgimit nga dt.08.02.2024 e deri me dt.08.03.2024, i cili denim do te ekzekutohet pas plotefuqishmerise se ketije aktgjykimi.

Duke aplikuar nenin 3 par.2 te KP-se, dhe nenin 44 te KP-se, me propozimin dhe pelqimin e te akuzuarit dhe mbrojtetit te tije avokat, kerkojne nga gjykata qe denimi i shqiptuar me burgim ne kohezgjatje prej 6 /gjashte/ muajve, ti zevendsohet me denim me gjobe. Gjykata denimin me burgim ne kohezgjatje prej 6 /gjashte/ muajve, i zevendsoi ne denim me gjobe në shumën prej **1.100,00 € (njemijeneqinde) Euro**, ne të cilën shume te denimit me gjobe do te llogaritet edhe koha e kaluar ne masen e paraburgimit nga dt.08.02.2024 e deri me dt.08.03.2024, pjesa tjetere e ngelur e denimit me gjobe ne shumen prej **540,00/peseqindekaterdhjete/euro** obligohet qe ta paguaje pas plotefuqishmerise se ketije aktgjykimi, i akuzuari denimin me gjobe do ta paguaje ne 5 kiste, ne rast te mospageses as me ekzekutim i njeiti denim me gjobe do te zevendsohet ne denim me burgim ashtu qe do te llogaritet per qdo 20 euro llogaritet 1 dite burgim respektivisht 27 dite burgim

Obligohet i akuzuari qe ti paguaj shpenzimet gjyqësore të procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor në shumën prej **20 euro**, ne emer te ekspertizes mjeko-ligjore shumen prej **20,00 euro**, dhe në emër të kompensimit të viktimave të kimit në shumën prej **20 euro**, në afat prej **15 ditëve**, nga dita e plotefuqishmerisë së këtij aktgjykimi nën kërcenim të ekzekutimit me dhunë.

Te demtuarat R. M., dhe e mitura-femiu S., K., nga Prizreni, rr....., per realizimin e kerkeses pasurore juridike udhezohen ne kontest te rregullt civilo-juridik

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritë aktakuzë PP/II nr.199-1/2024 të dt.28.02.2024, kundër të akuzuarit S.K., nga Prizreni, për shkak të veprës penale penale lëndim i lehte trupor nga neni 185 par.3 lidhur me par. 2 nenpar.3.2 e lidhur me par.1 nenpar.1.1 të KP-së,

Gjykata në shqyrtim fillestar ka vertetur gjendjen e ketille faktike nga pranimi i fajesisë nga ana e të akuzuarit e cila vullnetarisht e ka pranuar fajesin, për shkak të se ciles gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyres zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë prove e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në teresi ka vertetur se i akuzuari e ka kuptuar natyren dhe pasojat e pranimit të fajesisë për veprat penale e cila i vihet në bare, e që pranimi i fajesisë është bere në menyre vullnetare dhe pa kushtezime, duke u mbeshtetur në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat akuzuari ka qene i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhë në perfundim, se pranimi i fajesisë nga ana e të akuzuarit është bere në pajtim me nenin 242 par.1 e 2 nenpar.2.1, 2.2, 2.3, 2.4 të KPPK-se, dhe faktet që përmban aktakuzën, në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha tiparet dhe elementet e veprës penale lëndim i lehte trupor nga neni 185 par.3 lidhur me par. 2 nenpar.3.2 të KP-së, dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi denimin me gjobe, paraprakisht duke iu vertetur përgjegjësine e tije penalo-juridike.

Me rastin e caktimit të denimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 të KP-së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e denimit, duke mos e gjetur rrethanat posaqerisht rënduese, e si rrethane lehtësuese është marrë pranimi i fajesisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë i tije, në kuptim të nenit 70, 71 e 72 të KP-së, gjykata morri për bazë edhe faktin se e akuzuari ka bashkëpunuar me gjykatën, bashkëpunimi i tije ka qene vullnetar në hetimin dhe ndjekjen penale edhe të kryerësve të tjerë të veprave penale, ka pranuar fajesin vullnetshëm, pa presion e as pa ndikim nga jashtë, i premtori gjykates se në të ardhmen nuk do të perserise vepra të ketille penale, me të demtuarin duke i kërkuar publikisht falje, dëshiron ta gjeje gjuhen e pajtimit dhe të mirekuptimit, nga se jeton në një shtëpi dhe njerë e ka bashkeshorte e tjetren e ka vajze, si rrethane posaqerishte lehtësuese është marrë pranimi vullnetar i fajesisë, veprimi ka qene i qastit dhe nuk ka qene sa duhet i kujdesshem për këtë veper penale për shkak se ka qene në ndikimin e alkoolit, andaj gjykata me aplikimin e nenit 44 të KP-së, me pelqimin e të akuzuarit, denimin me burgim i ka zëvendësuar në denim me gjobe, sepse konsideron se me shqiptimin edhe të ketijë lloji denimit me gjobe, do të arrihet qellimi i denimit, duke menduar se denimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësise së tije, dhe me këtë do të ndikojë të i akuzuari që në të ardhmen të jetë i kujdesshem dhe të përmbahet nga veprimet e tilla të karakterit juridiko-penal.

Vendimi mbi për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 463 par.1 e 2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë konform nenit 452 par.2 të KPP-së.

Nga të cekurat më lart u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i pergjithshem Penal
P.nr.240/2024 të dt. 06.03.2024

Sekretare juridike
Fatime Bajraktari

Gjyqtari
Fatmir K.,

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi palët e pakënaqura kane te drejtë ankese në afat prej 30 ditëve nga dita e marrjes se te njëjtës, Gjykatës se Apelit ne Prishtine, e nëpërmjet te kësaj gjykate.